


# JETA E SHTETIT





# JEMI NE

# KUVENDI - SHTËPIA E DYTË E POPULLIT

ATDHEU (10), ARBNOR (10), DONARD (10), VALENTINA (10), YLLI (10)

Kuvendi i Kosovës



## Kuvendi i Kosovës ushtron Pushtetin Legjislativ

Sot ne mësuam për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që ndryshe quhet edhe Shtëpia e Popullit. Ne dëshirojmë që artikulli tonë ta fillojmë me një thënie shumë të rëndësishme: „Të qeverisësh do të thotë t'i bësh të tjerët të të besojnë.“ Kjo thënie ka qenë bazë për shumë njerëz që kanë dashur të fitojnë votën e qytetarëve. Pse quhet Shtëpia e Popullit?

Kuvendi i Republikës së Kosovës është një institucion shumë i rëndësishëm për ne qytetarët, sepse deputetët janë të zgjedhur nga populli, me vota të lira.



Disa nga kandidatët për deputet

Roli i deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës është ta përfaqësojnë popullin, i cili ia ka besuar votën. Por ajo se çka e bën më demokratik Kuvendin, është se qytetarët e Kosovës mund t'i ndjekin nga afër të gjitha takimet (seancat plenare) që Kuvendi i mban çdo javë. Kuvendi i Kosovës, përpos që ka për detyrë t'i përfaqësojë qytetarët, ai po ashtu ka edhe disa funksione të tjera, e ato janë: të propozoj dhe miratoj ligje, të zgjedh Presidentin, të miratoj buxhetin e Kosovës,

etj.

Pasi që Kuvendi ynë është Kuvend shumë partiakësh




Atdheu dhe Valentina, kandidat për deputet

dhe në të bëjnë pjesë 120 deputetë, 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 prej tyre janë nga komunitetet jo shumicë.

Të drejtën për të kandiduar për deputet e fitojmë pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare. Të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë tolerancë në mes vete, sepse Kuvendi i shtetit tonë është edhe burim i tolerancës, i drejtësisë dhe i mirëqenies.



Gazetarët e rinjë



**Qytetarët e mirë votojnë!**



**Nxënësit e mirë janë edhe qytetarë të mirë**



**Sot takuam ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**




**Gjatë bisedës me mysafirin tonë**



**Gazetarët duhet të bashkëpunojnë në mes vete**



**Ne kemi të drejtë të shprehim mendimet tona**




**Në demokraci, ne jemi të lumtur**



**Edhe pse të vegjël, ne punojmë shumë**

# QYTETARIA AKTIVE E KOSOVËS


ENIS (10), FJONDI (10), RINOR (11), LUMI (10), ERIS (10)



**Në këtë artikull do të lexoni për qytetarinë aktive në Kosovë. Atë e kemi shkruajtur ne, nxënësit e klasës së pestë**

Sipas nesh, të gjithë qytetarët e një vendi janë të regjistruar në regjistrin civil, i cili gjendet në secilën komunë. Të gjithë personat që jetojnë në Kosovë i quajmë qytetarë të Kosovës. Aty bëjmë pjesë edhe ne, fëmijët. Çdo qytetar ka të drejtë të arsimohet, të edukohet, të votojë, të protestojë e shumë gjëra të tjera me radhë. Ndërsa, të drejtat tonë si fëmijë janë: të luajmë, të shkollohemi, të ushqehemi mirë, të rritemi shëndetshëm, të kemi emër dhe mbiemër, të kemi vendstrehim dhe të na plotësohen kushtet elementare për jetesë. Të drejtat tona na i mbron Kushtetuta e Kosovës, dhe organizatat e tjera si Kryqi i Kuq, UNICEF, etj. Asnjë qytetar nuk duhet ta ndot ambientin, dhe gjatë gjithë kohës duhet të kujdeset që ambienti ynë të jetë i pastër. Po ashtu, secili qytetar ka përgjegjësi t'i re-

spektoj ligjet, të respektoj të tjerët, të respektoj të mosshuarit, të respektoj të rriturit etj. Në shkollë ne edukohemi dhe marrim shumë dije. Detyrat tona si nxënësit të mirë janë: të lexojmë, të shkruajmë, të bëjmë detyrat me kujdes dhe të respektojmë jo vetëm mësuesen, por edhe nxënësit më të mëdhenj dhe shokët e shoqet e klasës sonë. Kur të rritemi dhe të arrijmë moshën 18 vjeçare do të dalim të votojmë për deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe për kryetarin e komunës sonë. Ne gjithashtu do të ndihmojmë të gjithë personat, të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë. Edhe mysafiri ynë, Ministri i Arsimit z. Arsim Bajrami, i cili na vizitoi gjatë punëtorisë së sotme të demokracisë, na tha se Ministria e Arsimit dhe qytetarët e Kosovës duhet të ndihmojnë fëmijët me kushte të vështira ekonomike, duke u siguruar arsim më të mirë. Ne aq sa mësojmë, e ngrisim shtetin tonë. Çdo gjë që ne bëjmë, e bëjmë që shteti ynë të bëhet më i fortë.



Lulet tona



Grupi i gazetarëve të këtij artikulli

# QYTETARËT VENDOSIN PËR TË ARDHMEN


JASIN (10), DELFINA (10), BLERTA (11), ERBLIN (11), MUHAMET (10)

## Nga ne do të mësoni se si populli vendos për të ardhmen e vendit të tij

Votat e qytetarëve vlejné shumë, sepse nga votat e tyre zgjedhen deputetët apo përfaqësuesit e së ardhmes sonë. Të drejtën për të votuar e ka çdo qytetar që nga moshë 18 vjeçare dhe kjo e drejtë është formë e shprehjes së demokracisë. Edhe ne kur ta mbushim këtë moshë do të votojmë për zgjedhjet e vendit tonë. Pra, përmes votës, ne qytetarët e shprehim mendimin tonë lirshëm. Kosova si shtet i pavarur dhe demokratik i ka gjithsej 120 deputetë, të cilët marrin vendime për popullin dhe të cilët e zgjedhin edhe Presidentin e vendit. Ne kemi dy lloje të zgjedhjeve: zgjedhjet lokale dhe zgjedhjet qendrore. Në zgjedhjet lokale zgjedhen kryetarët e komunave, ndërsa në zgjedhjet qendrore zgjedhen deputetët. Andaj lexues të dashur, vota juaj ka vlerë të madhe dhe e ndryshon të ardhmen e vendit.




Gazetarët e Kuvendit të Kosovës



Element i demokracisë është edhe zgjedhja e lirë



Këto parime të demokracisë duhet të respektohen nga ne



Voto dhe ndrysho të ardhmen e popullit tënd



Kuvendi i Republikës së Kosovës



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Emin Duraku“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë